**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E FINANCAVE**
**DREJTORIA E SHOQERIVE PUBLIKE**
**Nr.2346 Prot.**

**Tirane,me 4-6 1996**

**U R D H E R**
**Nr150 Date 17.05.1996**

Ne baze te nenit 4 te Ligjit Nr.7926, date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare",

**U R D H E R O J**

1.Transformimin e Fabrika e Çimentos Elbasan shoqeri anonime te formes anonime Sh.A."Çimentos" Elbasan.

2. Anetare te Keshillit Mbikqyres caktohen.

1. Floreta Drinziu
2. Hasan Mydini
3. Albert Nini
4. Kujtim Bumçi

Anetaret e tjere te Keshillit Mbikqyres emerohen nga Ministria e Ndertimit dhe Turizmit.

3. Eksperte per vleresimin e kapitalit themeltar te tyre caktohet Mit'hat Vrioni.

Ngarkohet Drejtoria e Shoqerive Publike te ndjeke zbatimin e ketij urdheri.

Akti i themelimit, statuti i shoqerise, kerkesa per miratimin e eksperteve kontabel, kerkesa per rregjistrimin e shoqerise ne rregjistrin tregtar dhe aktet e tjera te nevojshme do te nenshkruhen nga Drejtori i Drejtorise se Shoqerive Publike.

**MINISTRI**

**Ridvan VRIONI**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERËVE ELBASAN**
**Nr.** 104 **Rep.**
**Nr.** 218 **Kol.**

TAKSA E PULLES

NOTER ELBASAN

## VENDIM

## I MBLEDHJES SË PËRGJITHËSHME (ASAMBLESË) TË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË "ELBASAN CEMENT FACTORY" SH.A.

Sot ditën e Enjte, në datën 20 Qershor 2002, Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë "Elbasan Cement Factory" Sh.A. e thirrur dhe mbledhur rregullisht, mbasi shqyrtoi pikën e tretë të rendit të ditës:

- Shndërrimi i Shoqërisë "Elbasan Cement Factory" nga shoqëri anonime në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me efekt që nga data 1 Janar 2002. Emërtimi tregtar i Shoqërisë, konfirmimi për vazhdueshmërinë e personit juridik "Elbasan Cement Factory" Sh.A. dhe rrjedhimisht mbartja, gëzimi dhe garantimi automatikisht e pa ndërprerje, i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të marra përsipër që nga krijimi i shoqërisë anonime,

**Me unanimitet**

**VENDOSI:**

**"Të shndërrojë Shoqërinë "Elbasan Cement Factory" nga shoqëri anonime në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me efekt që nga data 1 Janar 2002. Emërtimi tregtar i Shoqërisë do të jetë "Elbasan Cement Factory" Sh.p.k. Asambleja konfirmon që "Elbasan Cement Factory" Sh.p.k. është vazhdim i personit juridik "Elbasan Cement Factory" Sh.A. dhe rrjedhimisht mbart, gëzon dhe garanton automatikisht e pa ndërprerje, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër që nga krijimi i shoqërisë anonime."**

Ky vendim pasi lexohet dhe shihet i formuluar saktë nënshkruhet në prani të Noterit nga Drejtuesi dhe Sekretari i Asamblesë së Shoqërisë "Elbasan Cement Factory" Sh.A.

Drejtuesi i Asamblesë — Pierre Ysoyants

Sekretari — Artur Pilkati

NOTERI

NOTERE
ENKELEJDA MARINAJ